



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 06/2 prot

Datë 04.01.2024

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E
OFERTUESVE TË TJERË

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF- 85785-10-30-2023 me objekt “*Digjitalizimi i Njesisë Laboratorike të Histologjisë*”, me fond limit 13,099,697 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 15.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Universiteti Mjekësisë, Tiranë.

Lënien të skualifikuar të shoqërisë “Krijon” SHPK.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Atom” SHPK me NUIS L22203042N, me adresë: Rruga Islam Alla, Pallati 56, Kati 1, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Universiteti Mjekësisë, Tiranë me adresë: Rruga e Dibrës, Nr. 371, 1005, Tiranë.

Subjekte të Interesuar:

Operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK, me NUIS J61817047D, me adresë: Bulevardi Zhan D'ark, Nd.32, Hyrja 16, Kati 2, Ap.1, Tiranë

Operatori Ekonomik “Krijon” SHPK me NUIS K12023001A, me adresë: Farke, Rruga e Elbasanit, nr.57, Çollak, 1044, Tiranë.

Në datën 03.01.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 06/2024 protokoll dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3723 e operatorit ekonomik “Atom” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF- 85785-10-30-2023 me objekt “Digjitalizimi i Njësisë Laboratorike të Histologjisë”, me fond limit 13,099,697 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 15.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Universiteti Mjekësisë, Tiranë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit. Gjithashtu ankimesi kërkon lënien të skualifikuar të shoqërisë “Krijon” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë kriteret që operatori ekonomik “Atom” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga shoqëria “BNT Electronics” SHPK, të parashtruara në ankesën me nr. 06 prot., datë 03.01.2024.

Konkretisht në ankesë pretendohet për mospërmbushje nga ana e operatorit ekonomik “BNT Electronics” SHPK, të kriterëve si më poshtë vijon:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

2.3.1. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.*

- a) *Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara, ose*
- b) *Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë/broshurë me të dhënat teknike për pajisjet e ofruara, ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike për artikujt e kërkuar. **Në katalogë, të markohen në mënyrë të qartë dhe të dallueshme specifikimet, sipas modelit të deklaruar.** (Katalogu duhet të ngarkohet në [ëëe.app.gov.al](http://eëe.app.gov.al) së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT. Përshkrimi teknik duhet të jetë i përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe në pjesët që kanë lidhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST). Katalogjet do pranohen vetëm në formë elektronike nëpërmjet Sistemit Elektronik të Prokurimit.

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike, për pajisjet e kërkuara sipas tabelës së mëposhtëme:

Nr.	Emërtimi i produktit	Kompania prodhuese	Vendi i origjinës	Emërtimi i katalogut/brosurës së produktit	Numri i faqeve ku tëndodhen specifikimet	Certifikimet përkatëse të produktit (Certifikatë konformiteti sipas direktivës CE / FDA ose ekuivalente)
1						
2						
<i>Etj.</i>						

Shënim: AK rezervon të drejtën për verifikimin e certifikimeve përkatëse të produktit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit.

2.3.6 a) Operatori ekonomik për artikujt e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit duhet të paraqesë certifikatën “Për sistemin e menaxhimit të cilësisë” ISO 9001:2015, ose ekuivalente, (të përkthyer në shqip dhe të noterizuar) të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të artikujve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit).

b) Operatori ekonomik ofertues për artikujt mjekësor duhet të paraqesë **vetëdeklaratë** për certifikimin ISO 13485:2016 “Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore” ose ekuivalent, të prodhuesit, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Shënim: AK rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit.

Gjithashtu pretendohet se shoqëria “Krijon” SHPK përvec arsyeve të skualifikimit nga KVO-ja, nuk përmbush kriterin si vijon:

2.3.1. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.*

- c) *Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, ose*
- d) *Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 04.01.2024

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri